

Aleksandra Filipović
Milica Matanović
Ana Perunović- Razhnatović

AVENTURA E MUZIKËS 2

MANUALI PËR
MËSUESE/MËSUES
Kultura muzikore për klasën
e dytë të shkollës fillore



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2026

Aleksandra Filipović

Milica Matanović

Ana Perunović-Razhnatović

AVENTURA E MUZIKËS 2

Kultura muzikore

për klasën e parë të shkollës fillore

MANUALI për
mësuese/mësues

Botuesi

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve

Mësimore – PODGORICË

Për botuesin

Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor

Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës

Llazo Leković

Redaktore e botimit

Bilana Miranović

Redaktor në gjuhën shqipe

Dimitrov Popović

Recensentë

Dr. Vesna Vučinić

Mr. Natasha Popović

Mr. Vera Marković

Fran Vulaj

Radmila Bajković

Përkthyes

Luigj Dedvukaj, arsimtar i lëndës

Korrektura

Luigj Dedvukaj

Ilustrimet

Maria Popović

Disenjoja dhe faqosja

Millena Llakiqević

Faqosja

Marijana Simonović

Redaktore teknike

Dajana Vukčević



CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2580-9

COBISS.CG-ID 36994820

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendim nr. 05/3-01-119/24-5099/7 të datës 16. 7. 2024,
e ka miratuar këtë Manual për përdorim në shkollën fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2026

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	5
Udhëzime metodike për realizimin e orës mësimore.....	6
Klasa e dytë.....	8
Himni i Malit të Zi.....	10
1. TINGUJ, TONE DHE NOCIONE MUZIKORE (TERMAT).....	11
“Më lart – më poshtë”.....	12
Shkurt – gjatë.....	13
Zogu i humbur.....	15
Kush këndon?.....	17
2. THESARI POPULLOR.....	19
O, moj vajzë.....	19
Në Ivanin sundimtarin.....	21
O, Vërsutë, o mal i lartë.....	22
Unë mbolla farë shalqiri.....	23
Fli e rritu.....	24
Të gëzuar ne lundrojmë.....	25
Lodra (Daullja).....	26
Fyelli.....	27
3. KËNDOJMË PËR NATYRËN.....	28
Hëna	28
Ruaj pemët.....	29
Brumbujt dhe bletët.....	31
Ec rosaku i vogël.....	33
Pipi çorapëgjata.....	35
4. NJOHIM INSTRUMENTET.....	37
Kitara.....	37
Flauti.....	38
Fizarmonika.....	39
5. RITMI NA BËN TË LËVIZIM.....	40
Bukuritë e Malit të Zi	40
Java	41
Vëllezërit.....	42
Piratët.....	43
Loja	45
Vallja.....	47
Hoki-poki.....	49

6. DËGJIMORJA E MUZIKËS.....	51
Termet-nocionet muzikore përmes dëgjimit të muzikës.....	51
Identifikojmë shpejt dhe ngadalë	52
DITARI I DËGJIMEVE.....	53
Muzika dhe emocionet	53
SHTOJCË.....	55
Loja muzikore.....	55
LITERATURA	56

PARATHËNIE

Të nderuara kolege dhe të nderuar kolegë,

Para jush është manuali “Aventura Muzikore 2”. Ky manual është i ndarë në gjashtë kapituj me tema të ndryshme, të cilat ndjekin përmbajtjen e tekstit mësimor.

Që në fillim të manualit do t’i përshëndesim nxënësit dhe nxënëset me këngën “Klasa e dytë” dhe me Himnin e Malit të Zi. Kapitullin e parë e fillojmë me një rikujtim të asaj që kemi mësuar dhe dëgjuar në klasën e parë. Pastaj, përmes këngëve dhe lojërave, mësojmë për termat dhe nocionet e gjuhës muzikore; këngët dhe instrumentet popullore i mësojmë në kapitullin e dytë, në të tretin këndojmë për natyrën, ndërsa në të katërtin njihemi edhe me tri instrumente artistike. Në kapitullin e pestë realizojmë këngët e numërimit (lojërat muzikore), ritmogramet dhe vallëzimet, ndërsa në fund kemi lënë hapësirë për dëgjimin përjetues të muzikës në Dëgjimoren e muzikës.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit të aftësive muzikore dhe përzgjedhja e mirë e këngëve të numërimit, vallëzimeve-lojërave muzikore, shembujve për dëgjim dhe interpretim të ritmit ku do të kontribuojë në realizimin e suksesshëm të orës mësimore. Në manual do të gjeni shumë shembuj praktikë dhe aktivitete për realizimin e orës. Çdo temë mësimore është përshkruar në detaje, me rezultatet e të nxënit, metodat e punës dhe materialin përkatës që ndodhet në manual, siç janë partiturat e këngëve, përshkrimet e valleve-lojërave dhe këngëve të numërimit, ndërsa shembujt muzikorë-incizimet mund t’i gjeni përmes QR kodit. Gjatë mbledhjes së materialit, jemi përpjekur që ai të jetë krijues, inovativ, të zhvillojë imagjinatën e fëmijëve dhe në këtë mënyrë të zgjojë tek ta impulsin për lëvizje, interpretimin ritmik dhe këndimin e melodisë.

Udhëzimet metodike në manual ndjekin parimet themelore të metodikës së mësimdhënies së kulturës muzikore dhe janë të përgjithshme, ndërsa janë zhvilluar në mënyrë të detajuar brenda njësive mësimore. Theksojmë se renditja e temave mësimore në tekstin shkollor dhe në manual nuk ndjek Planin e Punës, por mësuesit dhe mësueset do të zgjedhin vetë kohën e realizimit të temave të caktuara.

Për përpunimin e temave mësimore është parashikuar një orë mësimore, por në varësi të mundësive, interesimit dhe arritjeve të nxënësve, sipas vlerësimit të mësuesve, temat mund të zhvillohen edhe në më shumë orë.

Besojmë se ky manual do të jetë një mjet i çmuar në punën tuaj dhe do të ndihmojë në krijimin e një ambienti imagjinues dhe krijues për aktivitetet muzikore të nxënësve tuaj. Ju urojmë punë të mbarë!

Autoret

UDHËZIME METODIKE PËR REALIZIMIN E ORËS MËSIMORE

Përshkrimet e detajuara të procedurave metodike për zbatimin e orës mësimore gjenden në manualin për klasën e parë, ndërsa këtu do të përmendim vetëm veçoritë që kanë të bëjnë me klasën e dytë.

Përpunimi i këngës me anë të veshit – përmes dëgjimit

Procedura metodike për përpunimin e këngës me anë të veshit – përmes dëgjimit, së bashku me hapat përkatës, është përshkruar në mënyrë të detajuar në manualin për klasën e parë. Programi mësimor për klasën e dytë parashikon përpunimin e këngës me anë të veshit – përmes dëgjimit, por përmes saj mësohen edhe disa nocione e terma të rinj muzikorë si: lëvizja e melodisë, këndimi me zë të ulët dhe të lartë, zgjatja e gjatë dhe e shkurtër e tingullit, e të tjera.

Për ta bërë përpunimin e këtyre nocioneve dhe termave më interesant dhe tërheqës, janë krijuar këngë të përshtatshme që përpunohen me anë të veshit – përmes dëgjimit dhe, njëkohësisht, përveç këndimit, përmes përvetësimit të tekstit të këngës, nxënësit mësojnë edhe termat dhe nocionet e reja muzikore.

Për disa këngë janë përfshirë edhe ilustrime me simbole që përshkruajnë lëvizjen e melodisë.

Nocionet bazë të gjuhës muzikore

Ky është një rezultat mësimor-edukativ me të cilin nxënësit dhe nxënëset përballen për herë të parë në arsimin fillor, ndaj është shumë e rëndësishme të orientohet me kujdes vëmendja e tyre. Për këtë qëllim janë krijuar këngë të posaçme si “Shkurt e gjatë” dhe “Më lart e më poshtë” të cilat janë të përshtatshme melodikisht dhe ritmikisht, dhe njëkohësisht shpjegojnë një koncept muzikor të caktuar.

Termt si kor dhe dirigjent i korit, nxënësit do t’i mësojnë përmes ilustrimeve dhe dëgjimit të muzikës.

Përpunimi i instrumenteve

Gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore për instrumentet, fillojmë me ato që janë mësuar në klasën e parë, përmes dëgjimit (me anë të veshit) të pjesëve muzikore tashmë të njohura. Kur prezantojmë një instrument të ri, është e dëshirueshme që t’u tregojmë nxënësve vetë instrumentin për të përforcuar përjetimin vizual.

Ora do të jetë edhe më e suksesshme nëse merr pjesë një solist – instrumentist, i cili demonstron mundësitë teknike dhe melodike të instrumentit. Në këtë klasë përpunohen kitara, fizarmonika dhe flauti nga grupi i instrumenteve artistike, ndërsa fyelli dhe daullja e vogël (lodra) nga grupi i instrumenteve popullore.

Lojërat muzikore

Në përputhje me rezultatet e parashikuara në Program, në tekstin mësimor janë përfshirë edhe disa lojëra muzikore. Lojërat e ndryshme muzikore kontribuojnë në zhvillimin e kreativitetit në shprehjen dhe përjetimin e muzikës. Ato përfshijnë këndimin, vallëzimin dhe aktivitete të tjera muzikore gjatë interpretimit, përmirësojnë perceptimin dëgjimor dhe kujtesën muzikore.

Përshkrime të detajuara të lojërave gjenden në skenarin e orës.

Ditari i dëgjimeve

Në këtë kapitull, nxënësit dhe nxënëset inkurajohen që përjetimet e tyre muzikore, mendimet dhe ndjenjat gjatë dëgjimit (me anë të veshit) të veprave muzikore t'i përshkruajnë dhe ilustrojnë me vizatime. Kjo formë shprehjeje u është e njohur që nga klasa e parë, por tani mësuesi/mësuesja i ndihmon nxënësit ta formësojnë përjetimin muzikor përmes udhëzimeve të përshatshme.

Dëgjimi aktiv i muzikës në orën e kulturës muzikore nënkupton identifikimin e elementeve shprehëse muzikore, ndaj është shumë e rëndësishme që tek nxënësit të zhvillohet dhe të kultivohet interesi për këtë fushë.

Vlerësimi i njohurive të fituara

Pas disa kapitujve janë përfshirë "Gjëegjëzat muzikore", të cilat janë hartuar si një formë kreative e vlerësimit të njohurive. Ato përmbajnë detyra që, në mënyrë tërheqëse, kërkojnë nga nxënësit të lidhin, të plotësojnë, të vizatojnë dhe kështu të përforcojnë dijet e fituara.

Klasa e dytë

(M. Martinoviq)

$\text{♩} = 110$

D D A A D D D A

Shko - lla nxën' - sit po i thë - rret, a - ven - tu - rë e re i pret.

5 D D A A D D A

Kla - sën e dy - të po fi - llo - ni, shko - lla ty të fis - ni - kë - ron.

9 D D A A D D A D

Me ha - re no - tat dë - gjoj - më, nxë - në - sit ta - në po gë - zoj - në.

13 D D A D A A D

Nga gë - zi - mi u shkël - qejn' syt', ta - ni për klas' të dy - të.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimet nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike me një diapazon prej katër tingujsh;
- të krijojë dhe interpretojë motive ritmike dhe efekte zanore me instrumente ritmike nga instrumentariumi i Orfit, bazuar në këngën, këngë të numërimit ose përmes lojërave muzikore.

Incizimi (shënime tingullore): kënga artistike "Klasa e dytë"

Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesi/mësuesja bisedon me nxënësit dhe nxënëset për pushimet verore: si i kaluan, ku udhëtuan, çfarë të re kanë mësuar. Diskutojnë për shkollën dhe detyrat e reja shkollore që i presin.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset ngrohën zërat duke kënduar një këngë të njohur.
- Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën "Klasa e Dytë". Pas dëgjimit diskutojnë për tekstin e këngës. Shikojnë tekstin në tekstin mësimor, ndërsa mësuesi/mësuesja u tërheq vëmendjen tek forma e shkronjave dhe fjalëve (parakusht është që disa

nxënës dhe nxënëse të njohin tashmë shkronjat). Analizojnë këngën pjesë-pjesë.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset mësojnë këngën si një këngë numërimi, duke shqiptuar me saktësi ritmin dhe tekstin e këngës.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesi/mësuesja interpreton këngën pjesë-pjesë, ndërsa nxënësit dhe nxënëset këndojnë dhe përsërisin disa herë secilën pjesë, derisa të zotërojnë të gjithë këngën.
6. **Hapi/aktiviteti i gjashtë:** Mësuesi/mësuesja ndan instrumentet ritmike të nxënësit dhe nxënëset. Bazuar në këngën e mësuar, nxënësit dhe nxënëset krijojnë motive ritmike në instrumente.

Himni i Malit të Zi



O, agim i ndritshëm maji, o, agim i ndritshëm maji.

Nëna jonë o, Mal i Zi-e, nëna jonë o, Mal i Zi-e.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

– të këndojë himnin shtetëror.

Incizimi (shënime tingullore): Himni i Malit të Zi

Ecuria e orës

Hapi/aktiviteti i parë: Mësuesi/mësuesja ushtron (i bën të ngrohin zërin) nxënësit dhe nxënëset.

- Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë Himnin e Malit të Zi dhe e njohin atë. Mësuesi/mësuesja bën pyetje për vendet ku e kanë dëgjuar himnin, në çfarë rastesh ai këndohet dhe si duhet të sillet secili gjatë ekzekutimit të himnit (parakusht është që nxënësit dhe nxënëset ta kenë dëgjuar më parë himnin në ndonjë garë sportive ose manifestim të ngjashëm).
- Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë tekstin e himnit dhe e analizojnë atë me ndihmën e mësuesit/mësueses. Pas analizës, vijon përpunimi i këngës sipas procedurës metodike për përpunim me anë të veshit.
- Vërejtje:** Për shkak të diapazonit-shtrirjes melodike dhe vështirësisë së tekstit, në klasën e dytë mësohet vetëm fillimi i himnit.

1. TINGUJ, TONE DHE NOCI- ONE MUZIKORE (TERMAT)

Çfarë kemi dëgjuar dhe mësuar?

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe emërtojë me dëgjim dhe në mënyrë vizuale ngjyrat e tingullit të trumbetës, pianos dhe instrumenteve ritmike nga instrumentariumi i Orfit;
- të këndojë këngë artistike dhe popullore;
- të njohë me dëgjim shembuj të propozuar muzikorë.

Incizimet (shënimet tungullore)

- V. A. Moxart: *Marshi turk*
- Xh. Verdi: *Marshi triumfal*
- Xh. Rosini: *Dueti i maceve*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesi/mësuesja ushtron (i bën të ngrohin zërin) nxënësit dhe nxënëset me këngën “Klasa e dytë”. Diskutojnë për tekstin e këngës dhe çfarë kanë mësuar në lëndën Kultura muzikore në klasën e parë.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesi/mësuesja udhëzon nxënësit dhe nxënëset të hapin tekstin mësimor-librin në faqen 8 dhe të shikojnë ilustrimet. Ata përshkruajnë ilustrimet (muzikën e interpretojmë duke kënduar, duke luajtur në instrumente, atë mund ta dëgjojmë), përshkruajnë pamjen e instrumenteve, i njohin ato dhe ripërsërisin njohuritë e fituara në klasën e parë (bëjnë detyrën 1 – Emërto instrumentet).
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesi/mësuesja lëshon për dëgjim kompozimet e V. A. Moxartit “Marshi turk”, XH. Verdit “Marshi triumfal” dhe Xh. Rosinit “Dueti i maceve”, duke kërkuar nga nxënësit dhe nxënëset që të njohin instrumentet që dëgjuan. Në librin e tyre në faqen 8, bëjnë detyrën 2 dhe lidhin ilustrimin me pjesën e dëgjuar dhe me kodin QR.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset njohin emrin e veprës që dëgjuan në klasën e parë (ose çfarë është përshkruar me muzikë). Përsërisin këngët që kanë mësuar në klasën e parë (sipas zgjedhjes).
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesi/mësuesja u jep nxënësve dhe nxënëseseve instrumentet e instrumentariumit Orf (rraketake-kërcitëse, shkopinj, daulle të vogla), dhe më pas kërkon që t’i emërtojnë dhe përshkruajnë ato. Nxënësit dhe nxënëset krijojnë dhe interpretojnë ritme me këto instrumente për këngën e zgjedhur.

“Më lart – më poshtë”

(A. Filipoviq)

$\text{♩} = 120$

Kur ti këndon pak më lart, pak më lart, pak më lart,

kur ti këndon pak më lart çoj duart lart.

Kur ti këndon pak më poshtë, pak më poshtë, pak më poshtë,

Kur ti këndon pak më poshtë, u lu pak më poshtë.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit të mësimimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të formësojë zërin-vokalin për këndim dhe të njohë lëvizjen e zërit (më lart – e më poshtë);
- të lidhë shënimin figurativ me drejtimin e vijës melodike (më lart – e më poshtë).

Incizimi (shënime tingullore): Kënga artistike Më lart – e më poshtë


Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset luajnë lojën “Marrim rrushin – tërheqim barin”. Me komandën “marrim rrushin”, nxënësit dhe nxënëset ngritin duart lart, ngjiten në majat e gishtave dhe imitojnë mbledhjen e rrushit, ndërsa në komandën “tërheqim barin” ata përkulen dhe imitojnë tërheqjen e barit. Pas përfundimit të lojës, ata komentojnë lëvizjet e trupit lart-poshtë, duke i krahasuar me aktivitete të përditshme (ngjitje dhe zbritje shkallësh, lëkundje në kolovajzë/shilarëse dhe të tjera të ngjashme).
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë incizimin e këngës Më lart – e më poshtë. Mësuesi/mësuesja i udhëzon të vërejnë gjatë dëgjimit për çfarë flet teksti i këngës, pastaj të vërejnë edhe lëvizjen melodike. Arrijnë në përfundimin që lëvizja e melodisë ka ndryshuar; në pjesën e parë melodia lëviz lart, ndërsa në pjesën e dytë poshtë. Përfundojnë duke kuptuar se tingujt mund të jenë më të lartë ose më të ulët.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesja/mësuesi përpunon këngën përmes metodës së përpunimit të këngës me anë të veshit - dëgjimit. Kur nxënësit dhe nxënëset e mësojnë këngën, ata e këndojnë individualisht ose në grup. Gjatë këndimit vërejnë lëvizjen melodike.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset në tekstin mësimor shikojnë shënimin muzikor të paraqitur me simbole. Ata lidhin shënimin figurativ me lëvizjen e melodisë. Gjatë këndimit të këngës tregojnë lëvizjen e melodisë me dorë dhe e krahasojnë me lëvizjen e djalit në shkallët që është ilustruar (faqja 9).

Shkurt – gjatë

(A. Filipoviq)

$\text{♩} = 120$



5
Ve - shi pan - ta - llo - na t'gja - ta dim - ri, n'di - mër, por në
Ndër - sa dim - rit, vi - shem me të gja - ta, t'gja - ta, kur - se,

8
ve - rë mëng' të shkurt - ra, këm - bë - zba - thur. Shkurt e gjat', mir'
n've - rë me pan - ta - llo - na të shkurt - ra.

për - he - rë, se shkurt vi - she - mi ne në ve - rë.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të lidhë shënimin figurativ me kohëzgjatjet e notave;
- të përshkruajë karakterin e kompozimeve të ndryshme me fjalët e veta;
- të improvizojë lëvizje duke dëgjuar shembuj muzikorë.

Incizimi (shënime tingullore): kënga artistike “Shkurt – gjatë”

J. Shtraus: *Picikato polka*

Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesja/mësuesi bën bisedë me nxënësit dhe nxënëset për kohëzgjatjet (në përgjithësi): sa zgjat dita, nata, ora, ora e mësimi, pushimi, afati i një produkti e të tjera të ngjashme. Arrijnë në përfundimin se gjithçka përreth ka një kohëzgjatje.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesja/mësuesi do të këndojë fillimisht disa tinguj me kohëzgjatje të ndryshme – të gjatë dhe të shkurtër; kur nxënësit dhe nxënëset të dallojnë kohëzgjatjet e ndryshme, do të luajë në piano tingullin e gjatë dhe të shkurtër. Nxënësit dhe nxënëset dallojnë ndryshimin në kohëzgjatje dhe kuptojnë se në muzikë mund të luajmë tinguj (tone) me gjatësi (kohëzgjatje) të ndryshme.
- Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë incizimin e këngës “Shkurt – gjatë” dhe më pas analizojnë tekstin.
- Hapi/aktiviteti i katërt:** Pas kësaj vijon përpunimi i këngës sipas metodës së përpunimit të këngës me anë të veshit - dëgjimit. Kur ta kenë mësuar këngën, nxënësit dhe nxënëset e këndojnë individualisht dhe në grupe, sipas zgjedhjes së tyre.
- Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset marrin një pozicion të rehatshëm dhe përgatiten për të dëgjuar muzikë. Ata dëgjojnë kompozimin “Picikato polka” të J. Shtrausit, me detyrë që të njohin se kush e interpreton veprën. Pas dëgjimit, me ndihmën e mësueses/

mësuesit, njohin se interpretojnë disa instrumente (me harqe). Në dëgjimin e dytë, nxënësit dhe nxënëset duhet të dallojnë nëse instrumentet luajnë nota të gjata apo të shkurtra. Në dëgjimin e tretë, mësuesja/mësuesi do t'u kërkojë nxënësve dhe nxënëseve që të ndiejnë pulsën e kompozimit dhe të bëjnë lëvizje në përputhje me të. Duke lëvizur spontanisht, ata përshkruajnë karakterin e lojës së kompozimit.

Zogu i humbur

(V. Tomerlin)

$\text{♩} = 100$

C C G C

Ke - mi pa - sur një zog shum' të vo - gël,

5 C C G C

një zog t' vo - gël gjy - sëm ki - lo - gra - mi.

9 C C G C

Por ky zo - gu na u zhduk, shko - ni dhe kër - ko - ni,

13 C G G C G

ndo - shta një dit' kthe - het prap, the - kër un' do t'i jap.

Kemi pasur një pul' shum' të vogël,
një pul' t' vogël me sy të artë.
por kjo pula na u zhduk, shkoni dhe kërkoni,
ndoshta një dit' kthehet prap,
thekër un' do t'i jap.

Kemi pasur elefant të vogël,
elefant të vogël një qind tonesh,
elefanti na u zhduk, shkoni dhe kërkoni,
ndoshta një dit' kthehet prap,
thekër un' do t'i jap.

Rezultatet e të nxënës

Gjatë procesit të mësim, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngën duke përdorur elemente shprehëse: tempin (shpejt-ngadalë), dinamikë (qetë - zëshëm), ngjyrën e tingullit (një ose më shumë interpretues, instrumente të ndryshme);
- të interpretojë koreografi të thjeshta mbi bazën e shembujve muzikorë të dëgjuar.

Incizimi (shënime tingullore): kënga artistike "Zogu i humbur"

F. J. Hajden: *Simfonia surprizë*

Ecuria e orës

- 1. Hapi/aktiviteti i parë/:** Mësuesja/mësuesi bën bisedë me nxënësit dhe nxënëset për lojërat (vallëzimet) muzikore që kanë mësuar deri më tani dhe ripërsëritin lojën "Vjeli, vjeli rrushin". Diskutojnë për këtë lojë (këngë) dhe ngrohen duke kënduar me anë të saj.

2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset mësojnë këngën për lojën muzikore “Zogu i humbur” me anë të dëgjimit, duke ndjekur metodologjinë e përcaktuar.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesja/mësuesi shpjegon rrjedhën e lojës.

Përshkrimi i lojës:

Një nxënës është kthyer me shpinë, ndërsa të tjerët fshehin një objekt. (Në orën e Kulturës së artit figurativ nxënësit mund të kenë përgatitur më parë një pulë prej plasteline, kartoni etj.) Derisa nxënësi me shpinë kërkon pulën e fshehur, të tjerët këndojnë këngën për ta ndihmuar ta gjejë, duke përdorur parimin e lojës “Nxehtë-ftohtë”. Kur nxënësi afrohet pranë vendit ku është fshehur objekti, kënga bëhet më e zëshme; kur largohet – bëhet më e qetë. Kur nxënësi e gjen objektin, loja mund të përsëritet me nxënësit e tjerë. Nxënësit shprehin gatishmërinë për të marrë pjesë në aktivitetet e klasës.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset përshkruajnë mënyrën se si kanë kënduar këngën. Arrijnë në përfundimin se muzika mund të interpretohet me intensitete të ndryshme (më e zëshme ose më e qetë). Zhvillojnë mendimin muzikor dhe kuptojnë cilësitë e tingullit/tonit: më i fortë/zëshëm ose më i butë/qetë.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesi/ja përmes bisedës ndihmon nxënësit të vërejnë ndryshimet mes kafshëve të përmendura në këngë (zogu – shpejt dhe i zhdërvjellët; pula – lëviz me shpejtësi mesatare; elefanti – ngadalë dhe me vështirësi). Në përputhje me këtë, interpretojnë çdo strofë të këngës në mënyrë të ndryshme. Përsërisin atë që kanë mësuar më parë – me cilën shpejtësi mund të interpretohet ndonjë kompozim muzikor.
6. **Hapi/aktiviteti i gjashtë:** Nxënësit dëgjojnë fragmentin muzikor “Simfonia surprizë” nga F. J. Hajden. Reagimet e pritshme janë: habi, çudi dhe gëzim. Mësuesi lexon legjendën për krijimin e këtij kompozimi. Legjenda tregon se Hajden vuri re që publiku shpesh ulej të flinte gjatë dëgjimit të muzikës në mbrëmje, pas darkës. Për shaka, Hajdeni në këtë vepër kompozoi një pjesë për t’u interpretuar në mënyrë jashtëzakonisht të lehtë dhe të qetë, në mënyrë që, në momentin kur dëgjuesit si zakonisht dremisin, të dëgjohej një shpërthim i fortë i orkestrës për të zgjuar publikun e përgjumur.
7. **Hapi/aktiviteti i shtatë:** Nxënësit dallojnë karakterin e kompozimit dhe e lidhin me mjetet shprehëse muzikore (si tempa dhe dinamika-ngjyrimi).

Kush këndon?

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë me dëgjim zërin e fëmijës dhe të të rriturve (zërin mashkullor dhe femëror);
- të shpjegojë termat-nocionet kor, dirigjent i korit, këndimi.

Incizimet (shënime tingullore): Ana Vujosheviq: “Mbylli sytë”

Regjistrim video dhe audio nga filmi për fëmijë Eni, *Tomorrow*
(pjesë për kor)

Muzikë për kor (sipas zgjedhjes)¹

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesi/mësuesja bisedon me nxënësit për muzikën që dëgjojnë në shtëpi. Nxënësit përshkruajnë këngët dhe këngëtarët e tyre të preferuar. Mësuesi mëson se ata ndjekin festivale për fëmijë ku marrin pjesë bashkëmoshatarët e tyre.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dëgjojnë shembullin muzikor nga festivali për fëmijë ku këndon Ana Vujosheviq, kënga “Mbylli sytë”, dhe njohin interpretuesin - zërin e fëmijës këngëtar.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit shikojnë dhe dëgjojnë regjistrimin (incizimet) video dhe audio nga filmi për fëmijë Eni, *Tomorrow* me detyrë që të njohin këngëtarët. Ata njohin zërin e fëmijës dhe më pas zërat mashkullorë dhe femërorë të të rriturve.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dëgjojnë muzikë korale dhe njohin se këndon një grup më i madh njerëzish – kori. Mësuesi shpjegon termat kor dhe dirigjent i korit. Nxënësit shohin ilustrimin e korit dhe dirigjentit në tekstin mësimor dhe flasin për rolin e dirigjentit. Mësuesi i kërkon nxënësve të imitojnë lëvizjet e dirigjentit duke ngritur dhe lëvizur duart si një dirigjent.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesja/mësuesi do të formojë një kor nga grupi i nxënësve. Nxënësi/nxënësja që dëshiron të jetë “udhëheqës kori” qëndron përpara korit, zgjedh njërin

¹ Burimi: YouTube

nga këngët që kanë mësuar më parë dhe drejton korin që të këndojë këngën. Gjatë interpretimit, duke luajtur rolin e drejtuesit të korit, ai/ajo tregon me dorë këngëtarët, të cilët duhet të ndjekin shpejtësinë dhe intensitetin e interpretimit. Pas përfundimit të pjesës muzikore, nxënësi/nxënësja tjetër bëhet udhëheqës i korit.

2. THESARI POPULLOR

O, moj vajzë (këngë popullore nga Mali i Zi)

$\text{♩} = 80$

O vaj - zë, o vaj - zë, mo - llë e ar - të,

5
O vaj - zë, o vaj - zë, mo - llë e ar - të,

Pash atë, pash atë qiell dhe kët' tokë,
a don kë, a don kë përveç meje ti?
Pasha kët', pasha kët', qiell dhe kët' tokë,
nuk dua, nuk dua askënd pos teje.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të mund:

- të njohë këngën që këndohet nën vallëzim dhe kërcim (kërcimtarja);
- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike;
- të lidhë shënimin figurativ me drejtimin e vijës melodike (lart-poshtë);
- të interpretojë kërcimtaren duke respektuar ritmin dhe tempin.

Incizimi (shënime tingullore): këngë popullore "O, moj vajzë"

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit këndojnë këngën e njohur popullore. Shpjegojnë çfarë është kënga popullore, si është krijuar dhe ku e kanë dëgjuar atë.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Për këtë orë mësimore, është e dëshirueshme të kemi mysafirë nga një Shoqëri kulturore artistike me kostumet popullore malazeze për femra dhe meshkuj. Nxënësit shikojnë kostumet dhe përshkruajnë pjesët e tyre, gjatësinë, ngjyrën dhe detajet e tjera. Mësuesi/Mësuesja përshkruan pjesë të veçanta dhe funksionin e tyre.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën "O, moj vajzë" ndërsa my-

safirët tregojnë hapat dhe kërcimin e saj. Duke parë kërcimtarin, ata vërejnë ritmin specifik dhe lëvizjet e kërcimit që shoqërojnë këtë këngë. Mësuesi/Mësuesja i shpjegon nxënësve se kjo është një valle (këngën që këndohet nën vallëzim dhe kërcim) popullore që quhet “Kërcimtarja” (gj. mlz. poskočica). Emri vjen nga mënyra e lojës dhe lëvizjet që kryhen gjatë këndimit.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit mësojnë këngën sipas metodës së mësimi me anë të veshit - përmes dëgjimit. Pasi kanë mësuar këngën, ata shikojnë shënimin figurativ dhe drejtimin e vijës melodike, duke vërejtur lëvizjen lart-poshtë.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mysafirët tregojnë si kërcëhet “kërcimtarja” dhe shpjegojnë hapat.
6. **Përshkrimi i lojës:**

Nxënësit formojnë një rreth ose gjysmë rrethi dhe këndojnë këngën “O, moj vajzë”, ndërsa një çift në qendër kërcen “kërcimtaren”. Çifti që ndahet e hyn në qendër me dy hapa të thjeshtë, ku djali duartroket dy herë në ritmin e dy të katërtave (2/4) dhe thërret: „Oj, ha!”. Çifti është i kthyer përballë njëri-tjetrit me fytyrë; djali me duart e hapura lart dhe vajza me duart e shtrira poshtë. Në këtë valle-lojë përdoren kërcime mbi këmbën e majtë me prekjen e tokës me këmbën e djathtë përpara këmbës së majtë, duke zgjatur një të katërt. Vallja popullore vazhdon të interpretohet deri sa të gjithë nxënësit dhe nxënëset të kenë kërcyer “kërcimtaren” nga njëherë.

Në Ivanin sundimtarin

(Këngë popullore nga Mali i Zi)

$\text{♩} = 100$

Në I - va - nin sun - dim - ta - rin, në I - va - nin sun - dim

7

ta - rin, sun - dim ta rin në I - va - nin sun - dim - ta - rin.

Shumë pasuri, shumë para,
shumë pasuri, shumë para,
shumë para,
shumë pasuri, shumë para,

Mbidhe me një ftua t' verdhë,
mbidhe me një ftua t' verdhë,
ftua t' verdhë,
mbidhe me një ftua t' verdhë.

Mbolla bredhin në një bjeshkë,
mbolla bredhin në një bjeshkë,
në një bjeshkë,
mbolla bredhin në një bjeshkë.

Ftua t' verdhë me një nerënxë,
ftua t' verdhë me një nerënxë,
me një nerënxë,
ftua t' verdhë me një nerënxë.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit të të nxënit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë vetëm dhe në grup këngë popullore dhe artistike;
- të lidhë shënimin figurativ me kohëzgjatjet e notave muzikore (e gjatë-e shkurtër);
- të ndjekë këngët dhe këngë numërimi me instrumentet ritmike të instrumentariumit Orf.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga popullore “Në Ivanin sundimtarin”


Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset ngrohin zërin duke kënduar këngën e njohur popullore. Përsërisin kërcimtarën - vallen dhe interpretojnë hapat.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën “Në Ivanin sundimtarin”. Analizojnë tekstin e këngës dhe vërejnë që është këngë popullore. Gjatë dëgjimit ata kuptojnë se kënga i ngjan himnit shtetëror. Nxënësit dhe nxënëset kujtojnë njohuritë e fituara për këngët popullore dhe kuptojnë që shpesh në krijimtarinë popullore hasim këngë me melodinë e njëjtë ose të ngjashme, por me tekste të ndryshme.
- Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset mësojnë këngën sipas metodës së përpunimit me anë të veshit - me dëgjim.
- Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset këndojnë këngën dhe ndjekin shënimin figurativ të linjës melodike. Vërejnë lëvizjen e melodisë lart dhe poshtë, dhe gjatë këndimit tregojnë lëvizjen e melodisë me lëvizje dore.

5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesja/mësuesi do të ndajë nxënësve instrumente ritmike – daulle të vogla dhe rraketake, pastaj do të formojë dy grupe. Gjatë këndimit, nxënësit dhe nxënëset, me nxitjen e mësueses/mësuesit, do të luajnë ritmin e këngës në instrumente.

O, Vërsutë, mal i lartë

(këngë popullore nga Mali i Zi)



Nga ty rrjedhin plot burime,
bari rritur gjer' në gjunjë,
pylli mbushur gjith' gjelb'rim-e.
Delet ruan çobanesha,
nga spiçani sokolesha.

Rezultatet e të nxënësve

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të mund:

- të njohë kërcimtaren;
- të interpretojë kërcimtaren duke respektuar ritmin dhe tempon;
- të këndojë vetë dhe në grup këngë popullore dhe artistike.

Incizimi (shënime tingullore): kënga popullore "O, Vërsutë, mal i lartë"

Video-regjistrim i lojës-valles Vërsuta

Ecuria e orës:

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset këndojnë këngën "O, moj vajzë". Diskutojnë për përshtypjet nga ora kur e kanë mësuar këtë këngë, përshkruajnë kërcimtaren.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën "O, Vërsutë" dhe e njohin si këngë popullore nga Mali i Zi. Mësuesja/mësuesi shpjegon titullin e këngës, çfarë është Vërsuta dhe ku ndodhet, pastaj analizojnë tekstin e këngës. Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën dhe vërejnë ritmin e saj dhe shpjegojnë se ritmi është i ngjashëm me ritmin e këngës "O, moj vajzë". Arrijnë në përfundimin se edhe kjo këngë ka ritmin dhe karakterin e kërcimtares.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset mësojnë këngën sipas metodës së përpunimit me anë të veshit – me dëgjim.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë video-regjistrimin e lojës që shoqëron këngën, pastaj krijojnë lëvizje duke u bazuar në shembullin nga video-regjistrimi.

Unë mbolla farë shalqiri

(këngë popullore nga Serbia)

$\text{♩} = 120$

C G C C G C

U në mbo - lla far' shal - qi - ri, pran' uj it të stu de ni cës,

5 G C G C G D G G D G

sa - në, kash - të, sa - në, kash - të, tër - shë - rë, tër - shë - rë.

U mësua motra Dorë,
kështu vodhi tre motorë,
sanë, kashtë, sanë, kashtë,
tërshërë, tërshërë.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimimit nxënësi/nxënësja do të mund:

- të këndojë këngë popullore dhe artistike, individualisht dhe në grup;
- të interpretojë koreografi të thjeshta mbi shembuj muzikorë të dëgjuar;
- të ndjekë këngë dhe këngë numërimi në instrumente ritmike të Orfit (triangli).

Incizimi (shembulli tingullor): kënga popullore *Unë mbolla farë shalqiri*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesi/mësuesja luan melodi nga këngë të njohura popullore. Nxënësit dhe nxënëset përpiqen të gjejnë se cila këngë u luajt nga mësuesi/mësuesja. Arrijnë në përfundimin se të gjitha këngët të përbashkët kanë se janë këngë popullore.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë tekstin e këngës që lexon mësuesi/mësuesja dhe e analizojnë atë. E shohin këngën në tekstin mësimor dhe konstatojnë se kjo është një këngë popullore nga Serbia.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Më pas vijon përpunimi i këngës sipas metodës së përcaktuar për përpunimin e këngës me anë të veshit - me dëgjim.
4. **Hapi 4/aktiviteti i katërt:** Mësuesi/mësuesja udhëzon nxënësit dhe nxënëset për përshkrimin e lojës dhe koreografinë që shoqëron këngën.

Përshkrimi i lojës:

Nxënësit dhe nxënëset kapen për dore në një rreth të mbyllur. Lëvizin dy takte në anën e djathtë, pastaj dy takte në anën e majtë (për çdo rrokje nga një hap). Në fjalët “sanë, kashtë” qëndrojnë në vend, duke shtrirë këmbën e majtë përpara asaj të djathtë dhe anasjelltas. Në fjalët “tërshërë, tërshërë” herën e parë në ritëm godasin-i bien me radhë me këmbë në tokë (njëherë me njëren, e njëherë me tjetrën), dhe kur përsërisin fjalët herën e dytë, në ritëm trokasin shu-

plakë më shuplakë.

5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset vëzhgojnë instrumentin në faqen 19 të tekstit mësimor. Ai është triaglli (treëndëshi). Me ndihmën e mësuesit/mësueses përshkruajnë instrumentin. Mësuesi/mësuesja shpjegon se si përdoret dhe me ndihmën e tij nxënësit dhe nxënëset ndjekin interpretimin e këngës me triangel (për shembull në pjesën e tekstit: tërshërë, tërshërë.).

Fli e rritu

(këngë popullore nga Bosnja dhe Hercegovina)

$\text{♩} = 80$
C

Fli e rri tu zog' pe - tri - ti, fli e rri - tu zo - gu im. Mbi ty do të

6 mbësh - te - te mi me duar do të mbu - loj - më fli e rri - tu ti mor' bi - ri im

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mëimit nxënësi/nxënësjë do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike;
- të përshkruajë karakterin e kompozimeve të ndryshme me fjalët e tij/saj.

Incizime (shënime tingullore): kënga popullore *Fli e rritu* (nga Bosnja)

kënga popullore e lules *Fli foshnjë; Përkund djepin* (fragment)

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti:** Nxënësit dhe nxënëset ngrohin zërin duke kënduar këngën e njohur Në Ivanin sundimtarin.
2. **Hapi/aktiviteti:** Mësuesja/mësuesi lëshon incizimin e këngës *Fli e rritu*. Pasi dëgjojnë këngën, ata bisedojnë për tekstin dhe arrijnë në përfundimin se kënga është një këngë djepi – ninullë dhe flet për një nënë që i këndon djalit para se të flejë. Bazuar në melodinë dhe tekstin, me ndihmën e mësueses/mësuesit, kuptojnë që kjo është një këngë popullore ninnanë nga Bosnja.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Më pas vijon përpunimi i këngës sipas metodës së përpunimit me anë të veshit – me dëgjim.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Pasi ta kenë mësuar këngën, nxënësit dhe nxënëset e këndojnë individualisht dhe në grup (sipas zgjedhjes).
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë shembullin *Fli foshnjë; Përkund dje-*

pin. Pas dëgjimit të fragmentit, ata e njohin që këngën e interpretojnë instrumente dhe zëri (femëror). Përveç pianos, nxënësit dhe nxënëset njohin edhe lahutën, dhe vërejnë praninë e instrumenteve popullore dhe artistike. Ata përsëri rrëfejnë me fjalët e tyre tekstin dhe arrijnë në përfundimin se edhe kjo këngë është një këngë djepi-ninullë. Përshkruajnë ndjenjat në këngë: butësi, dashuri, nënë e kujdesshme.

Të gëzuar ne lundrojmë

(këngë popullore nga Anglia)

$\text{♩} = 180$
F C F

5 C F

Rezultatet e të nxëniet

Gjatë mësimimit nxënësi/nxënësjë do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë popullore individualisht dhe në grup;
- të lidhë shënimin vizual me kohëzgjatjet e notave (gjatë-shkurt);
- të ndjekë këngët dhe këngët e numërimit në instrumentet ritmike të instrumentariumit të Orfit.

Incizimi (shënime tingullore): kënga popullore *Të gëzuar ne lundrojmë*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë dhe njohin zërin dhe zhurmën e detit. Përshkruajnë çfarë bëjmë në det (zhytemi, notojmë, hidhemi në ujë). Në pyetjen se me çfarë mjetesh lëvizim në det, nxënësit përgjigjen me anije, barkë, skuter dhe së bashku me mësuesen/mësuesin arrijnë në përfundimin se për këtë lëvizje themi se ne “lundrojmë në det”.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë incizimin e këngës *Të gëzuar ne lundrojmë* dhe tregojnë përmbajtjen e tekstit. Duke parë tekstin mësimor, vërejnë se bëhet fjalë për një këngë popullore angleze.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pason përpunimi i këngës me metodën e përpunimit me anë të veshit - me dëgjim. Kur kënga të jetë mësuar, nxënëset dhe nxënësit e këndojnë individualisht ose në grup. Ata shikojnë shënimin vizual të këngës dhe vërejnë kohëzgjatjet e gjata dhe të shkurtra të tingujve.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Mësuesja/mësuesi do t'u ndajë nxënësve instrumente ritmike dhe do t'u kërkojë që vetë të krijojnë një shoqërim ritmik për këngën.

Lodra (Daullja)

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë vizualisht dhe me dëgjim instrumentin dhe ta emërojë atë (lodra-daullja).

Incizimi (shënime tingullore): lodra (daullja)

Ekzekutimi i valles popullore të Rugovës (incizimi audio dhe video)

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë një incizim për lahutën. Kur e njohin shembullin e incizimit, kujtojnë njohuritë e fituara për këtë instrument në klasën e parë. Përshkruajnë instrumentin dhe tingullin e tij.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë incizimin audio dhe video të instrumentit lodra dhe diskutojnë për mënyrën e tij të luajtjes dhe pamjen. Arrijnë në përfundimin se është një instrument popullor ku tingulli prodhohet nga goditjet. Shikojnë instrumentin në libër dhe e përshkruajnë atë. Mësuesja/mësuesi u shpjegon atyre se instrumenti quhet lodra, por mund të dëgjoni emërtime edhe si daulle, tupan.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Dëgjojnë një incizim shembull tingullor dhe komentojnë tingullin e instrumentit.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë incizimin video të lojës-valles popullore "Rugova" në interpretimin e një shoqërie kulturore-artistike dhe vërejnë përdorimin e lodrës/tupanit në atë lojë.

Fyelli

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje të:

- njohë vizualisht dhe me dëgjim instrumentin dhe ta emërojë (fyelli);
- të performojë koreografi të thjeshta në bazë të shembujve muzikorë të dëgjuar.

Incizimi (shënime tingullore): fyelli

Vallja e Bokës – valle popullore nga Mali i Zi (incizimi audio dhe video)

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesi/mësuesja bisedon me nxënësit/et për instrumentet popullore dhe këngët që kanë mësuar deri tani.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit/et dëgjojnë incizimin e instrumentit dhe përshkruajnë tingullin e tij. Pastaj shikojnë incizimin video dhe vërejnë se tingulli prodhohet duke fryrë (në tubin e instrumentit). Mësuesi/mësuesja shpjegon pamjen e instrumentit, tregon emrin e tij (fyelli) dhe thekson se është një instrument popullor.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit/et shikojnë incizimin audio dhe video të *Valles së Bokës*, njohin vallen popullore. Mësuesi/ja shpjegon prejardhjen, kush dhe kur e vallëzon. Nxënësit dhe nxënëset, me udhëzimet e mësuesit/mësueses, ekzekutojnë hapat e *Valles së Bokës* – ekzekutojnë koreografinë e thjeshtë, duke respektuar ritmin me kujdes.

Vërejtje: Për të përforcuar përshtypjen dhe njohuritë e nxënësve rreth krijimtarisë popullore, rekomandohet të ftohet një interpretues (valltar ose instrumentist) si mysafir në orë. Nxënësit dhe nxënëset në këtë mënyrë krijojnë një përshtypje gjithëpërfshirëse për trashëgiminë kulturore. Për të bashkëpunuar me komunitetin lokal, është e këshillueshme një vizitë në një shoqatë kulturore-artistike ku nxënësit mund të marrin një përvojë më të plotë dhe të kuptojnë më mirë traditën popullore dhe mënyrën e interpretimit.

3.

KËNDOJMË PËR NATYRËN

Hëna (A. Filipoviq)

$\text{♩} = 70$

Kush nxi - ton i qe - të kur te - rri kap - lon?

5 Zhdu - ket kur del die - lli, kur rrez - ja ndri - çon.

9 Mbas fu - shës e ma - lit die - lli pe - rën - don,

13 shkël - qen si ar - gjen - di, na - tën kur ënd' - rron.

Rezultatet e të nxënës

Gjatë mësimi nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të formësojë zërin vokal dhe të njohë lëvizjen e tij (lart e poshtë);
- të lidhë shënimin figurativ me lëvizjen melodike (lart e poshtë);
- të përdorë vizatimin, lëvizjen ose përshkruan në mënyrë narrative mendimet, imazhet dhe ndjenjat personale për shembullin muzikor.

Incizimi (shënime tingullore): kënga artistike *Hëna*

K. Debysi: *Drita e hënës* (fragment)

Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset këndojnë këngën e njohur.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit diskutojnë për ndryshimet në natyrë dhe ndërrimin e ditës dhe natës, pastaj luajnë lojën “Natë-Ditë”. Pas lojës komentojnë pse “dita” është lart (dielli lind), dhe “nata” poshtë (dielli perëndon). Pyeten: Çfarë ndodh kur bie nata? Parashikohet që nxënësit të thonë se shohin hënën.

3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dëgjojnë këngën Hëna, dhe pastaj me ndihmën e mësueses/mësuesit analizojnë tekstin e këngës. Pas kësaj, vazhdon përpunimi i këngës me anë të veshit - me dëgjim. Gjatë këndimit, nxënësit dhe nxënëset njohin lëvizjen e zërit lart e poshtë. Ata lidhin shënimin figurativ me lëvizjen e linjës melodike dhe ekzekutojnë këngën e mësuar, në grup ose individualisht.
4. **Hapi i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset, sipas udhëzimeve të mësueses/mësuesit, dëgjojnë me kujdes shembullin (K. Debysi – *Drita e hënës*) dhe vërejnë se kompozicioni luhet në instrument – piano. Ata e dëgjojnë përsëri shembullin, me detyrë të përshkruajnë ndjenjat e tyre gjatë dëgjimit (qetësi, ndjeshmëri, që të lë gjumë, butësi). Nxënësit dhe nxënëset përgjigjen në pyetjen se cilën pjesë të ditës (natën) do ta përshkruanin me këtë shembull (natë). Gjatë dëgjimit të muzikës, ata imagjinojnë një pamje: janë në një anije të vogël që lundron në një lumë të qetë, nuk dëgjohet dhe nuk shihet asgjë tjetër, vetëm hëna që ndriçon natyrën.

Mësuesja/mësuesi thekson titullin e shembullit që dëgjuan, *Drita e hënës* nga K. Debysi, dhe e shkruan emrin e kompozitorit në tabelë. Nxënësit dhe nxënëset e shënojnë këtë në Ditarin e dëgjimit. Përsëri dëgjojnë shembullin dhe në Ditarin e dëgjimit vizatojnë linja, skica dhe figura që përputhen me lëvizjen e përjetuar të muzikës. Pasi përfundojnë, vazhdojnë me komentet mbi punimet.

Vërejtje: Sipas dëshirës, nxënësit dhe nxënëset mund të ekzekutojnë lëvizje të kërcimit, sepse ky shembull është ideal për ekzekutimin e koreografisë.

Ruaj pemët

(këngë nga Boka e Kotorrit)

$\text{♩} = 80$

Ja - nit po i lu - tet mo - lla, mos m'i the de - gët e ho - lla.

5

Ja - nit po i lu - tet mo - lla, mos m'i the de - gët e ho - lla.

Mos t'i Jano, mos m'i the deg't,
mos m'i the deg't, mos më thyej.

Çdo degë me nga dy mollë,
e n'maje dhe katër t'tjera.

Unë për ty kam lindur farën,
çdo degë me nga dy mollë.

Nuk e dëgjon Jani i vogël,
veç thyen drurin e njomë.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike;
- të realizojë aranzhime të thjeshta ritmike në instrumente ritmike të instrumentariumit Orf;
- të formësojë zërin e këndimit dhe të njohë lëvizjen e zërit (lart e poshtë);
- të lidhë shënimin figurativ me lëvizjen e melodisë (lart e poshtë).

Incizimi (shënime tingullore): Këngë popullore nga Boka e Kotorrit *Ruaj pemët*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset ngrohin zërin me një këngë të njohur (sipas zgjedhjes).
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë fruta të ndryshme nga natyra që mësuesja/mësuesi ka përgatitur dhe sjellë në orë: kokrra pishe, mollë, dardhë, degë pise, degë jargavani. Ata i përshkruajnë dhe shpjegojnë rolin e frutave dhe llojin e pemës. Njohin frutat që konsumohen në ushqim; pishat krijojnë hije; jargavani jep aromë të këndshme. Me nxitjen e mësueses/mësuesit, nxënësit dhe nxënëset flasin për ruajtjen e natyrës, pse është e rëndësishme dhe si duhet të ruhet natyra.
3. **Hapi /aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën *Ruaj pemët* dhe më pas flasin për tekstin e këngës. Pason përpunimi i këngës me anë të veshit – me dëgjim. Kur kënga është mësuar, ata e këndojnë individualisht ose në grup.
4. **Hapi /aktiviteti i katërt:** Mësuesja/mësuesi do t’u ndajë nxënësve instrumente ritmike – tamburin, rraketaket ose shkopinjte. Ata shikojnë shënimin figurativ dhe e lidhin me lëvizjen e linjës melodike (lart-poshtë). Sipas udhëzimeve të mësueses/mësuesit, nxënësit dhe nxënëset realizojnë një shoqërim të thjeshtë ritmik në këngë.
5. ***Për nxënësit/et e talentuar/a:** Nxënësit dhe nxënëset krijojnë vetë ritmin si shoqërim për melodinë/këngën e dhënë.

Brumbujt dhe bletët

(autor i panjohur)

$\text{♩} = 100$



Gjith' brum - bujt u bash - ku - an dhe ble - tët i sul - mu - an:

5

“çfar’ - re - ndi është ky, të mos je - pni mjalt’?”

Bletët thanë “punoni, pastaj ëmbëlsohuni”.
“s’është’ kjo për ne”, ato bënë be.
“e, t’mos ishit të uritur”,
thanë bletët pun’tore,
“ju shkurt i ratë,
nuk japim mjaltë”.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike;
- të përdorë vizatime, lëvizje ose tregim për të shfaqur/përshkruar mendime personale, imazhe dhe ndjenja mbi shembuj muzikorë të përshtatur për moshën e klasës së dytë;
- të përshkruajë karakterin e kompozimeve të ndryshme me fjalët e veta.

Incizimi (shënime tingullore): këngë artistike Brumbujt dhe bletët

N. R. Korsakov: *Fluturimi i brumbullit*

Ecuria e orës

1. **Hapi i parë/aktiviteti:** Nxënësit dhe nxënëset bashkëbisedojnë me mësuesin/mësuesen për stinët e vitit. Mësuesja/mësuesi i ndihmon të njohin stinën kur gjithçka zgjohet, lulëzon dhe rritet. Ata njohin pranverën. Diskutojnë për pranverën, ngjarjet në pyll dhe në livadh, duke u përqendruar në një kafshë të vogël punëtore, shumë të rëndësishme për ne, sepse bën mjaltë. Nxënësit dhe nxënëset njohin bletën në ilustrim që tregon mësuesja/mësuesi dhe flasin për jetën e bletës. Nëse ka mundësi, mësuesja/mësuesi shfaq një video për

jetën e bletëve.

2. **Hapi i dytë/aktiviteti:** Nxënëset dhe nxënësit dëgjojnë shembullin muzikor të këngës *Brumbujt dhe bletët*, analizojnë tekstin, përshkruajnë brumbujt që nuk punojnë, në kontrast me bletët punëtore. Mësuesja/mësuesi këndon këngën dhe më pas e përpunon me metodën e përpunimit të këngës me anë të veshit. Kur kënga është mësuar, mësuesja/mësuesi formon dy grupe, “brumbujt” dhe “bletët”, të cilat, duke ndjekur tekstin e këngës, interpretojnë në mënyrë të ndërruar duke ndjekur dialogun nga teksti.
3. **Hapi i tretë/aktiviteti:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë shembullin e N. R. Korsakov Fluturimi i brumbullit. Me dëgjim të kujdesshëm dhe me ndihmën e mësueses/mësuesit, ata njohin instrumentet me hark, përfshirë violinën, për të cilën kanë mësuar në klasën e mëparshme. Vërejnë edhe një instrument tjetër dhe përshkruajnë se ai luan tinguj të lartë (flauti, i cili mësohet në këtë klasë, ndaj ky shembull rekomandohet për përpunimin e flautit). Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë shembullin edhe njëherë dhe komentojnë shpejtësinë e interpretimit (tempi i shpejtë) dhe fuqinë-intensitetin e tingullit (që ndryshon).
4. **Hapi i katërt/aktiviteti:** Mësuesja/mësuesi i udhëzon nxënësit dhe nxënëset të lëvizin lirshëm në klasë; kur orkestra luan më fuqishëm – ata p.sh. vrapojnë dhe përhapin krahët, kur orkestra luan më qetë/lehtë – ata lëvizin ngadalë. Të gjitha këto ndryshime përshkruajnë me besnikëri një banor të livadhit. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et që, bazuar në lëvizjen e melodisë, fuqinë dhe tingujt që dëgjojnë, të njohin insektin që fluturon (brumbulli).
5. **Hapi i pestë/aktiviteti:** Mësuesja/mësuesi shkruan në tabelë titullin e shembullit të dëgjuar. Nxënësit dhe nxënëset përshkruajnë me fjalët e tyre, pastaj ilustrojnë shembullin e dëgjuar në Ditarin e dëgjimit.

Ec rosaku i vogël

(muzika I. L. Kalinski, teksti: G. Tartala)

♩ = 100

C **C** **G** **C**

Ky ro - sa - ku çap çup, për di - ku udh' - ton,

5 **C** **C** **G** **C**

bish - tin e tund nga pak, sqe - pi i zver - dhon.

9 **F** **C** **G** **C**

Për - shën - det si ush - tar: tra - ta ta - ta - ta,

13 **F** **C** **G** **C**

të la - het është ni - sur, tho - të kua, kua, kua.

Rezultatet e të nxënimit

Gjatë mësimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike;
- të formësojë zërin për këndim dhe të njohë lëvizjen e zërit (lart-poshtë);
- të lidhë shënimin figurativ me drejtimin e vijës melodike lart-poshtë;
- të luajë në instrumente ritmike të instrumentariumit Orf;
- të përshkruajë karakterin e kompozicionit me fjalët e veta.

Incizimi (shënime tingullore): kënga artistike *Ec rosaku i vogël*

K. Sen-Sans: *Akuariumi*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset, me udhëzimet e mësuesit/mësueses, imagjinojnë se ndodhen në një fermë/fshat dhe flasin për kafshët që mund të takojnë aty (dele, lopë, pula, rosa). Mësuesi/mësuesja do t'u kërkojë nxënësve dhe nxënëseve të imitojnë

zërat e kafshëve të ndryshme. Ndër të tjera, ata imitojnë zërin që bën rosaku (kua-kua). Përshkruajnë si duket rosaku, çfarë ha dhe ku jeton.

2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën Ec rosaku i vogël dhe më pas analizojnë tekstin që flet për rosakun e vogël që shkon për not.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Më pas vijon përpunimi i këngës sipas metodës së përpunimit me anë të veshit muzikor - dëgjimit. Gjatë këndimit, nxënësit dhe nxënëset formësojnë zërin për këndim, dallojnë lëvizjen e zërit lart-poshtë, pastaj ndjekin shënimin figurativ në librin mësimor dhe e lidhin me vijën melodike.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset, me ndihmën e mësuesit/mësueses, krijojnë një ritëm në instrumentet ritmike të instrumentariumit Orf dhe e interpretojnë atë. Për shkak të ritmit, tekstit dhe karakterit të këngës, sugjerimi është që të përdoret tamburi i vogël.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset marrin pozicion për të dëgjuar muzikë. Mësuesja/mësuesi lëshon kompozimin Akuariumi i K. Sen-Sans. Pas dëgjimit, nxënësit dhe nxënëset njohin se kompozimi interpretohet nga instrumentet. Midis instrumenteve kanë njohur pianon. Dëgjojnë shembullin edhe një herë dhe vënë re ndryshimin e fuqisë së tingullit-intensitetin. Para dëgjimit të fundit, mësuesi/mësuesja tregon ilustrime të fundit të detit, akuariumit dhe ilustrimeve kontraste. Nxënësit dhe nxënëset zgjedhin ilustrimin përkatës bazuar në pjesën e dëgjuar.
6. **Hapi/aktiviteti i gjashtë:** Mësuesi/mësuesja shkruan në tabelë titullin e veprës dhe emrin e kompozitorit.

Pipi çorapegjata

(M. Matanoviq)

$\text{♩} = 100$

C Am

Bo - ta saj fan - ta - zma, gu - xim - shëm me të shkon,

3 Dm

a - jo e di gjith - çka dhe në det po lun - dron.

5 C Am

Ço - ra - pet i gë - zo - hen, me la - ra të ndry - shme,

7 Dm G

flo - kët ku - qër - re - më, e bë - jnë të çu - dit - shme.

10 C Am Dm

Pi - pi është e fort' dhe gu - xim - ta - re, Në të diç fshi - het
Pi - pi është e fort' dhe gu - xim - ta - re, Me të ç - do herë

13 1. G 2. C

fu - qi e pa - pa - rë a - ven - tu - rë vër - tet.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të formësojë zërin për këndim;
- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike.

Incizimi (shënime tingullore): kënga artistike *Pipi Çorapegjata*

Ecuria e orës:

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesi/mësuesja përgatit për nxënësit një lojë asociacioni. Zgjidhja përfundimtare e lojës është Pipi Çorapegjata. Kur arrijnë në zgjidhje, diskutojnë për leximin që kanë përpunuar nga lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë kutojnë për përmbajtjen e tregimit dhe personazhet. Rikujtojnë cilësitë që ka Pipi dhe përmendin sjelljen dhe mënyrën e saj të veshjes.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit shohin ilustrimin në tekstin mësimor ku Pipi është në kalë. Përshkruajnë aventurat e Pipit dhe rikujtojnë edhe aventurat e tyre personale.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesi/mësuesja lexon tekstin e këngës Pipi Çorapegjata. Nxënësit komentojnë tekstin dhe vërejnë se autori i tekstit ka përcjellë cilësitë e vajzës Pipi në vargje, ndërsa kompozitori i ka përshkruar me muzikë.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit mësojnë këngën sipas metodës së përpunimit me anë të veshit muzikor.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Në orën tjetër, pasi të jetë mësuar kënga, propozohet dramatizimi i saj.

4. NJOHIM INSTRUMENTET

Kitara

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të emërtojë vizualisht dhe të dallojë me anë të dëgjimit instrumentin (kitarë);
- të njohë përmes dëgjimit shembujt muzikorë të propozuar.

Incizimet (shënime tingullore): N. Paganini: Kapris nr. 24

F. Tarrega: *Kujtimet e Alhambrës*

Ecuria e orës

1. Nxënësit/et dëgjojnë kompozimin “Kapris nr. 24” të N. Paganinit me detyrën të njohin instrumentin që dëgjojnë. Pasi njohin violinën, përforcojnë njohuritë e mëparshme dhe me ndihmën e mësuesit/es e klasifikojnë violinën si instrument me tela. Përshkruajnë mënyrën se si përftohet tingulli.
2. Nxënësit dëgjojnë incizimin e kitarës me detyrë që të njohin instrumentin. Kur njohin kitarën, mësuesja/mësuesi tregon ilustrimin dhe shpjegon pamjen e instrumentit. Nxënësit/et përshkruajnë ilustrimin dhe shpjegojnë që kitara ka gjashtë tela, dhe më pas shikojnë një video ku vërejnë se tingulli prodhohet/përftohet nga tërheqja (pickimi-dridhja) e telave me gishta ose me dridhëse/fletëz.
3. Nxënësit dëgjojnë kompozimin “Kujtimet e Alhambrës” të F. Tarregës dhe përshkruajnë me fjalët e tyre tingullin – të mprehtë, të fuqishëm, të thellë.
4. Mësuesja/mësuesi u tregon nxënësve se në tekstin mësimor, faqe 33, ndodhet një puzël muzikore. Nxënësit/et duhet të presin copat dhe t’i bashkojnë për të formuar instrumentin që kanë mësuar.
5. Në libër, faqe 51, ka udhëzime se si të bëhen instrumente muzikore. Mësuesi i udhëzon nxënësit/et të përgatitin materialet e nevojshme për orën dhe të marrin pjesë në krijimin e instrumentit të tyre.

Flauti

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë vizualisht dhe me dëgjim instrumentin dhe ta emërtojë atë (flauti);
- të njohë me dëgjim shembujt muzikorë të propozuar.

Incizime (shënime tingullore): N. R. Korsakov: *Fluturimi i brumbullit*

K. Sen-Sans: *Zogjtë*

Ecuria e orës:

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset së bashku me mësuesen/mësuesin flasin për instrumentet, mënyrën e prodhimit të tingullit dhe rikujtojnë ndërtimin e tyre.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozimin “Zogjtë” të K. Sen-Sans me detyrë që të njohin instrumentin. Me ndihmën e mësueses/mësuesit kuptojnë se tingulli prodhohet duke fryrë në tub. Nxënësit dhe nxënëset shikojnë incizimin video dhe përshkruajnë pamjen e flautit, pozicionin gjatë luajtjes dhe lëvizjet që bëhen me gishtërinj.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozimin e njohur “Fluturimi i brumbullit” të N. R. Korsakov dhe e njohin shembullin. Mësuesja/mësuesi i ndihmon të dallojnë pjesën ku dëgjohet flauti dhe të vërejnë se ai tingëllon lart dhe me zë të theksuar.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset zgjidhin detyrën në tekstin mësimor në faqen 34.

Fizarmonika

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë vizualisht dhe me dëgjim instrumentin dhe ta emërtojë atë (fizarmonika);
- të njohë me dëgjim shembujt muzikorë të propozuar.

Incizime (shënime tingullore): L. van Bethoven: *Për Elizën*

A. Pjacolla: *Libertango*

Ecuria e orës:

- 1. Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dëgjojnë kompozicionin “Për Elizën” të L. van Bethovenit me detyrë që të njohin instrumentin. Kur njohin pianon, rikujtojnë njohuritë e fituara më parë. Nxënësit dhe nxënëset komentojnë që pianoja ka taste dhe se ka instrumente të tjera që, ashtu si pianoja, kanë taste.
- 2. Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesja/mësuesi e lëshon incizimin e fizarmonikës, kompozimin “Libertango” të A. Pjacollës. Pas dëgjimit nxënësit dhe nxënëset komentojnë se kanë dëgjuar tingull të fortë dhe ritëm të shpejtë dhe dramatik. Mësuesja/mësuesi tregon ilustrimin, kurse nxënësit njohin fizarmonikën.
- 3. Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset shikojnë ilustrimin e instrumentit dhe me fjalët e tyre përshkruajnë pamjen e tij. Shpjegojnë, me udhëzimin e mësueses/mësuesit, që fizarmonika ka taste (tastierë) në anën e djathtë dhe “butona” (bas) në anën e majtë. Mësuesja/mësuesi shpjegon se tingulli prodhohet duke shtypur tastet ose butonët dhe duke shtrirë pjesën që quhet rrësheku (kaceku). Nxënësit dhe nxënëset shikojnë një video-incizim dhe vërejnë se si mbahet fizarmonika gjatë lojës.
- 4. Hapi/aktiviteti i katërt:** Si aktivitet përfundimtar, nxënësit dhe nxënëset kanë për detyrë të presin një *puzëll* dhe ta montojnë atë për të formuar instrumentin muzikor që kanë mësuar. Një herë tjetër dëgjojnë shembullin muzikor dhe imitojnë mënyrën e të luajturit të fizarmonikës.

Shënim: Siç është përmendur disa herë, më e mira është që në kabinet të ketë një instrument, ose që mësuesi/ja të ftojë në orë një instrumentist (ekzekutues në atë instrument).

5. RITMI NA BËN TË LËVIZIM

Bukuritë e Malit të Zi (M. Papiq)

Pod - go - ri - cë, Ce - ti - në, Bud - vë, Nik - shiq e Be - ran',
li - qen't bashk me fu - sha, bjesh - kët e - dhe de - ti,
jan' bu - ku - rit' tu - a, o y - ni Mal i Zi.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë të numërimit me ritme të thjeshta dhe me temp të përcaktuar (shpejt-ngadalë) dhe me dinamikë (qetë-zëshëm);
- të ndjekë këngët dhe këngë të numërimit me instrumente ritmike nga instrumentariumi Orf.

Ecuria e orës

- Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset përsërisin këngën e njohur të numërimit.
- Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit bashkë me mësuesen/mësuesin bisedojnë për udhëtime: në cilat qytete kanë qëndruar në Mal të Zi, cilat qytete u pëlqejnë dhe përse, nëse kanë vizituar ndonjë liqen, lumë...
- Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë interpretimin e këngës së numërimit, pastaj diskutojnë tekstin dhe mësojnë këngën e numërimit sipas metodologjisë së përcaktuar.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset ushtrojnë interpretimin e këngës së numërimit. Mësuesja/mësuesi e interpreton këngën e numërimit pjesë-pjesë, ndërsa nxënësit dhe nxënëset ndjekin dhe përsërisin pjesët.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Kur ta kenë mësuar këngën e numërimit, mësuesja/mësuesi do të ndajë nxënësit dhe nxënëset në dy grupe. Një grupi do t'i ndahen shkopinj, ndërsa grupit tjetër zile. Nxënësit dhe nxënëset e këndojnë fjalëkëmbimin duke shoqëruar me instrumentet ritmike.

Java

(A. Filipoviq)

Nu - më - roj di - tët e ja - vës, që du - hen më - su - ar,

gjit - sej a - to ja - në shta - të, e ke - ni kup - tu - ar?

E hë - në është dit' e pa - rë, e mar - tja qe - shet pa fjal',

të mër - ku - rën e pres te - zen, e të enj - ten rri ve - tëm,

e prem - tja pa - ra t'shtu - nës, e shtu - nja pran të die - lës.

Shta - të di - të që ka ja - va, num' - ro - ji nga e pa - ra.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësjja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë të numërimit me ritme të thjeshta dhe me temp të përcaktuar (shpejt-ngadalë) dhe me dinamikë (qetë-zëshëm);
- të lidhë shënimet vizuale me kohëzgjatjen e notave muzikore (gjatë-shkurt);
- të interpretojë koreografi të thjeshtë mbi shembujt e dëgjuar;
- të përshkruajë karakterin e kompozimeve të ndryshme me fjalët e veta.


Incizimi (shënime tingullore): Momçillo Bajagiq Bajaga: *Kënga e numërimit*

Ecuria e orës:

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset, duke përdorur instrumente ritmike, përsërisin këngën e numërimit "*Bukuritë e Malit të Zi*". Diskutojnë me mësuesen/mësuesin rreth asaj se çfarë janë këngët e numërimit dhe si i interpretojmë ato, duke theksuar se është e rëndësishme të theksohen pjesë të caktuara të tekstit gjatë shqiptimit dhe që kjo të përputhet me ritmin.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë tekstin e këngës së numërimit "*Java*". Diskutojnë rreth tekstit, pastaj mësuesi/mësuesja interpreton këngën e numërimit me theksime të sakta në ritëm dhe tekst. Nxënësit dhe nxënëset mësojnë tekstin e këngës së numërimit. E përsërisin disa herë derisa ta mësojnë saktë të shqiptojnë tekstin dhe të interpretojnë ritmin e këngës së numërimit.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Vërejnë kohëzgjatjet e ritmit (më i gjatë dhe më i shkurtë), duke ndjekur shënimet vizuale të këngës së numërimit. Interpretojnë ritmin e këngës së numërimit me rraketake.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën Kënga e numërimit (Brojalica). Komentojnë tekstin dhe karakterin e këngës (e gëzuar) dhe njohin se kush interpreton këngën (kori i fëmijëve). Bashkë me këngën krijojnë dhe interpretojnë lëvizje me duar (p.sh. tregojnë numrat me gishta), që korrespondojnë me tekstin e këngës.

Vëllezërit

(M. Matanoviq)



Në - na Pa - lin e lav - dë - ron, ush - qim t'shën - det - shëm kur kër - kon,

5
ai han vez', fru - ta e mjal't', ndo - një - her' dhe mar - me - lat'.

9
Me vë - lla për - gjys - më e ndan', çdo kaf - sha - të bash - kë e han'

13
v'lla - i shum' e fa - lë - nde - ron, "ti vog - lush je shpre - sa jo - në".

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë të numërimit me ritme të thjeshta dhe me temp të përcaktuar (shpejt-ngadalë) dhe me dinamikë (qetë-zëshëm);
- të lidhë shënimet vizuale me kohëzgjatjen e notave muzikore (gjatë-shkurt);

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset, me instrumente ritmike, përsërisin këngën e numërimit.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Dëgjojnë tekstin e këngës së numërimit “Vëllezërit”. Diskutojnë me mësuesen/mësuesin për tekstin. Flasin për vëllezërit dhe motrat e tyre dhe nëse ndajnë gjëra me ta. Mësuesja/mësuesi interpreton këngën e numërimit me theksime të sakta në ritëm dhe tekst. Nxënësit dhe nxënëset shikojnë shënimin vizual dhe e lidhin atë me kohëzgjatjet e notave, duke vënë re simbolet më të mëdha dhe më të vogla.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset, pasi mësojnë tekstin e këngës së numërimit, e interpretojnë atë me ndihmën e instrumenteve ritmike. E përsërisin disa herë derisa ta mësojnë saktë.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset, me ndihmën e mësueses/mësuesit, krijojnë lëvizje për këngën e numërimit dhe më pas secili interpreton këngën e numërimit me lëvizjet që ka krijuar. Në vend të emrave që shfaqen në këngë të numërimit, përdorin emrin e tyre dhe emrin e vëllait, motrës, shokut ose shoqes.

Piratët

(autor i panjohur)

9
Pi - ra - tët lun - drojn' në të ftoh - tin det, fsheh - tas the - sa - ri a - ta i thë - rret.

17
N'a - ni - je një kën - gë me zë ush - ton, më fort se rru - fe gjë - më dhe stu - hi.

Me ka - pi - te - nin çdo dit' kër - koj - në, the - sa - rin e fsheht' që ta zbu - loj - në.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë procesit të të nxënit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngë të numërimit me ritme të thjeshta dhe me temp të përcaktuar (shpejt-ngadalë) dhe me dinamikë (qetë-zëshëm);
- të lidhë shënimet vizuale me kohëzgjatjen e notave muzikore (gjatë-shkurt);
- të përshkruajë karakterin e kompozimeve të ndryshme me fjalët e veta;
- të përdorë lëvizjen dhe rrëfimin për të shprehur mendimet dhe ndjenjat personale.

Incizimi (shënime tingullore): Muzika nga filmi Piratët e Karaibeve (*Pirates of the Caribbean*)

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset, me instrumente ritmike, rikujtojnë/përsërisin ndonjë nga këngët e numërimit të mësuara më herët. Diskutojnë me mësuesen/mësuesin rreth asaj çfarë janë këngët e numërimit dhe si i interpretojmë ato, është me rëndësi që të theksojmë pjesë të caktuara të tekstit gjatë shqiptimit dhe ta përshtatim këtë me ritmin.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesja/mësuesi interpreton këngën e numërimit *Piratët* me theks të saktë në ritëm dhe tekst. Nxënësit dhe nxënëset mësojnë tekstin e këngës së numërimit. E përsërisin disa herë, derisa ta mësojnë tekstin. Vërejnë kohëzgjatjet ritmike (të gjata dhe të shkurtra), duke ndjekur shënimet vizuale të këngës së numërimit.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesja/mësuesi u shpërndan instrumentet ritmike, dhe nxënësit ushtrojnë ritmin e këngës së numërimit. Pasi ta kenë mësuar, mësuesja/mësuesi i inkurajon që në çifte ta interpretojnë këngën e numërimit të mësuar. Nxënësit kanë disa minuta kohë për të provuar vetë të krijojnë një shoqërim ritmik dhe ta interpretojnë para klasës.
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë me vëmendje shembullin (pjesën nga filmi *Piratët e Karaibeve*). Kanë për detyrë ta përshkruajnë se çfarë lloj muzike është (e fuqishme, e fortë, e butë, e qetë). Mësuesja/mësuesi e lëshon përsëri muzikën dhe kësaj radhe kërkon prej nxënësve të përshkruajnë ritmin dhe shpejtësinë e muzikës që dëgjojnë (e shpejtë, e theksuar). Pastaj u kërkon që të ngrihen dhe të lëvizin në ritmin e muzikës duke bërë lëvizje ose të krijojnë një koreografi. Parashikohet që nxënësit do të bëjnë lëvizje të shpejta dhe të papritura.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesja/mësuesi u tregon nxënësve se tema e këtij shembulli muzikor, ashtu si edhe e kënga e numërimit e mësuar, janë piratët që lundrojnë në dete të stuhishme, dhe se ritmi dhe shpejtësia e muzikës janë të njëjta me luftën e tyre kundër dallgëve të mëdha.

Loja

(M. Matanoviq)

$\text{♩} = 110$

D A A D D D G A D

Dy du - ar gjith - sej dhe dhje - të gish - ta, dy ve - shë dhe një hun - dë e vo - gël

5 D A A D D G D A D

dy sy - të që shkël - qejn' në e - rrë - si - rë dhe një është go - ja që puth në - nën e vet.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë të nxënit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike.
- të lidhë shënimin figurativ me drejtimin e vijës melodike (ngjitje–zbritje);
- të realizojë koreografi të thjeshta në bazë të shembujve muzikorë të dëgjuar.

Incizimi (shënime tingullore): Këngë artistike “Loja”

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit bashkë me mësuesen/mësuesin bisedojnë për ndërtimin e trupit të njeriut, duke përmendur: duart, këmbët, qafën, kokën...
2. **Mësuesja/mësuesi u thotë një gjëgjëzë:**
 - Birbiqët thurin,
 - birbiqët qëndisin,
 - birbiqët ecin vetë,
 - birbiqët udhëheqin vallen.

Nxënësit duhet të gjejnë për cilat pjesë të trupit bëhet fjalë (gishtat).

3. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset njihen me tekstin e këngës dhe kuptojnë se ajo flet për gishtat, pastaj mësojnë këngën sipas metodës së përcaktuar. Në tekstin mësimor vëzhgojnë shënimin figurativ dhe drejtimin e vijës melodike (ngjitje–zbritje).

4. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Mësuesja/mësuesi demonstroi lëvizjet që do të shoqërojnë këndimin e këngës së re:
- **Dy duar gjith** – nxënësit dhe nxënëset tregojnë duart dhe gishtat;
 - **sej dhe dhjetë gishta** – nxënësit dhe nxënëset rrahin katër herë shuplakat, pastaj dy herë kërcasin me gishta;
 - **dy veshë dhe një** – tregojnë veshët;
 - **hundë e vogël** – nxënësit dhe nxënëset katër herë rrahin shuplakat, pastaj një herë trokasin me gishta;
 - **dy sytë që shkël-...** – tregojnë sytë;
 - **qejn' në errësirë** – nxënësit dhe nxënëset katër herë rrahin gjunjët (u bien me duar), pastaj dy herë rrahin me shuplaka;
 - **dhe një është goja** – tregojnë gojën;
 - **puth nënën e vet** – nxënësit dhe nxënëset katër herë rrahin gjunjët, pastaj dy herë shuplakat.
5. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset e interpretojnë koreografinë e mësuar individualisht ose në grup. Mund të krijojnë edhe një koreografi tjetër të frymëzuar nga teksti i këngës.

Vallja

(M. Matanoviq)

$\text{♩} = 95$
C G C

Haj - de, haj - de në va - lle, për - plas du - art me ha - re.
Ka - pu e kër - ce si pat', e kën - do me zë të lart.

4 C G C

Rro - tu - llo - hu si në det, e kën - do me zë të qet'.

Hajde, hajde në valle,
përplas këmbët me hare.
Ka-pu e kër-ce si pat',
e kën-do me zë të lart.
Rrotullohu si në det,
e këndo me zë të qet'.

Hajde, hajde në valle,
përsërit ti bashk' me ne.
Ka-pu e kër-ce si pat',
e kën-do me zë të lart.
Rrotullohu si në det,
e këndo me zë të qet'.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë të nxënit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë këngën duke përdorur elemente shprehëse: tempin (shpejt–ngadalë), dinamikën (lehtë–fort);
- të realizojë koreografi të thjeshta në bazë të shembujve muzikorë të dëgjuar.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga artistike “Vallja”

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset bisedojnë bashkë me mësuesen/mësuesin për tonet, rikujtojnë këngën “Gjithçka që dëgjon”. Flasin për fuqinë (zërin) dhe kohëzgjatjen e tonit (tingullit).
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë këngën, e analizojnë tekstin bashkë me mësuesen/mësuesin dhe më pas e mësojnë sipas metodës së përcaktuar. Mësuesja/mësuesi shpjegon se pas çdo dy vargjesh në strofën e parë, nxënësit duhet të rrahin shu-

plakat, pastaj e demonstroi ritmin e dhënë. Në strofën e dytë, në të njëjtat pjesë të këngës, nxënësit dhe nxënëset duhet të bëjnë zhurmë me këmbë, ndërsa në strofën e tretë me te dyja (duhet të rrahin shuplakat dhe të godasin me këmbë njëkohësisht).

3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pasi kënga është mësuar, të gjithë nxënësit dhe nxënëset ushtrojnë lëvizjet dhe luajnë lojën.

Përshkrimi i lojës:

- **Hajde, hajde në valle,** – të gjithë nxënësit dhe nxënëset kapen dorë për dorë në një rreth (valle).
- **Përplas duart me hare.** – nxënësit dhe nxënëset ndalojnë dhe duartrokin në të njëjtin ritëm; nëse ju duket më e lehtë, mund të thonë: 1, 2; 1, 2, 3.
- **Kapu e kërce si pat',** – sërish kapen në rreth-valle dorë për dorë.
- **E këndo me zë të lart'.** – përsërisin ritmin e mësuar me zë të lartë.
- **Rrotullohu si në det',** – sërish kapen dorë për dorë.
- **E këndo me zë të qet'.** – përsërisin ritmin me zë të ulët-qetë.

Përsëritja në vazhdim është me goditje të këmbës në tokë:

- **Hajde, hajde në valle,** – të gjithë nxënësit dhe nxënëset kapen në rreth,
- **Përplas këmbët me hare.** – nxënësit dhe nxënëset ndalojnë dhe godasin këmbët në tokë në të njëjtin ritëm.

Loja vazhdon derisa të këndohet kënga deri në fund.

Hoki-poki

(Xhimi Kenedi)

$\text{♩} = 120$

Ti vën - dos këm-bën e majt' pa - ra, ven - dos këm-bën e majt' jasht, ti ven - dos

këm - bën e majt' pa - ra, dhe tun - de ti ve - ten tash. Ti bën një ho - ki po - ki dhe e

prek hun - dën me dor', e gji - thë kjo është një loj'.

Ti vendos dorën e majt' para, vendos dorën e majt' jashtë,
ti vendos dorën e majt' para, dhe tunde ti veten tash.

Ti bën një hoki poki dhe e prek hundën me dor',
e gjithë kjo është një loj'.

Ti vendos krahun e majt' para, vendos krahun e majt' jashtë,
ti vendos krahun e majt' para, dhe tunde ti veten tash.

Ti bën një hoki poki dhe e prek hundën me dor',
e gjithë kjo është një loj'.

Ti vëndos kokën tënde para, vendos kokën tënde jashtë,
ti vendos kokën tënde para, dhe tunde ti veten tash.

Ti bën një hoki poki dhe e prek hundën me dor',
e gjithë kjo është një loj'.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të këndojë individualisht dhe në grup këngë popullore dhe artistike;
- të improvizojë lëvizje duke dëgjuar shembullin muzikor;
- të interpretojë koreografi të thjeshta në bazë të shembujve muzikorë të dëgjuar.

Incizimi (shënime tingullore): Kënga artistike *Hoki Poki*

Ecuria e orës

4. **Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit ngrohin zërin duke kënduar një këngë të njohur.
5. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dëgjojnë incizimin muzikor të këngës. Më pas, së bashku

me mësuesen/mësuesin, analizojnë dhe komentojnë tekstin e këngës.

6. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Pason përpunimi i këngës sipas procedurës metodike për përpunimin-mësimin e këngës me anë të veshit - dëgjim.
7. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset interpretojnë koreografinë duke ndjekur lëvizjet e mësueses/mësuesit, dhe më pas e prezantojnë-ekzekutojnë koreografinë individualisht, në çift ose në grup. Sipas dëshirës, nxënësit dhe nxënëset komentojnë dhe interpretojnë pjesën më interesante të këngës. *(Duke qenë se teksti i këngës është i qartë, nuk është e nevojshme të shpjegohet dhe përshkruhet loja në manual – mjafton të ndiqet teksti.)*

Vërejtje: Koreografia mund të ekzekutohet edhe gjatë një shfaqjeje-programi artistik në klasë.

6. DËGJIMORJA E MUZIKËS

Termat-nocionet muzikore përmes dëgjimit të muzikës

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimit, nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të njohë me dëgjim zërin e fëmijëve dhe të të rriturve (zërat e meshkujve dhe femrave);
- të shpjegojë termat: kor, dirigjent-udhëheqës kori, këndimi.

Incizimi (shënime tingullore): V. A. Moxart: *Shiko lojërat janë të bukura*

Kor Perpetuum Jazzile: *Afrika* (kënga e grupit Toto)

S. St. Mokranjac: *Tufë këngësh* (zgjedhje)

Ecuria e orës

- 1. Hapi/aktiviteti i parë:** Nxënësit dhe nxënëset ripërsërisin një këngë të njohur dhe më pas përshkruajnë zërat e shokëve të klasës individualisht (a tingëllojnë zëra të thellë apo të lartë). Mësuesja/mësuesi u thotë: "Nëse do t'i caktonit një ngjyrë zërit të tyre, cilën ngjyrë do të zgjidhnit (e verdhë, jeshile, blu, e kuqe)?" Nxënësit dhe nxënëset komentojnë dhe argumentojnë përgjigjet e tyre.
- 2. Hapi/aktiviteti i dytë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë kompozimin e V. A. Moxart *Shiko lojërat janë të bukura*, me detyrë të njohin kush po këndon (zë fëmije me shoqërim të pianos). Më pas përshkruajnë zërin e fëmijës.
- 3. Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë grupin vokal *Perpetuum Jazzile dhe këngën Afrika*, me detyrë të njohin kush po këndon. Në fillim të veprës dëgjojnë ushtrimin Shiu pastaj këngën. Pas dëgjimit të shembullit, pritet që nxënësit dhe nxënëset të komentojnë se kanë dëgjuar zëra të të rriturve. Më pas, nxënësit dhe nxënëset, përsëri dëgjojnë këngën edhe një herë, dhe kanë për detyrë të vërejnë nëse ka ndonjë tjetër që bashkëkëndon (disa nxënës mund të thonë se dëgjojnë instrumente). Mësuesi/mësuesja shfaq-lëshon një video të kësaj vepre dhe nxënësit/et kuptojnë se vepra interpretohet vetëm me zëra njerëzorë (nga të rriturit). Nxënësit komentojnë se tingëllon si të kishte instrumente. Mësuesi/mësuesja shpjegon se kjo është një mënyrë e veçantë interpretimi që përfshin imitimin e tingujve të instrumenteve përmes zërit. Imitimi i zërit të baterive (daulleve) quhet

“beatbox”.

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Nxënësit dhe nxënëset diskutojnë për termat (nacionet) e mësuar më parë: – *kori* (grup i madh këngëtarësh), – *dirigjent kori* (*udhëheqës kori*), më pas dëgjojnë një pjesë nga *Tufë kënga* (sipas përzgjedhjes së mësuesit).

Identifikojmë shpejt dhe ngadalë

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimi nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të përdorë vizatime, lëvizje ose tregime për të shprehur mendimet, imazhet dhe ndjenjat e tij/saj ndaj shembujve muzikorë të përshtatur për moshën;
- të komunikojë me të tjerët për përjetimet e tij/saj muzikore dhe t'i argumentojë ato;
- të përshkruajë karakterin e kompozimeve të ndryshme me fjalët e veta.

Incizimi (shënime tingullore): R. Shuman: *Kalorësi i egër*

T. Albinoni: *Adaxhio*

Ecuria e orës

1. **Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesi/mësuesja krijon atmosferë për dëgjimin e muzikës duke i bërë nxënësit dhe nxënëset të dëgjojnë një shembull të njohur muzikor (sipas zgjedhjes). Nxënësit komentojnë ndjenjat që kanë përjetuar gjatë dëgjimit, ndryshimet në shpejtësinë dhe fuqinë-intensitetin e interpretimit.
2. **Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesi/mësuesja i informon nxënësit se gjatë orës do të dëgjojnë shembuj të ndryshëm muzikorë dhe do të kryejnë detyra të ndryshme. Ai/ajo përgatit rathë prej kartoni në ngjyrë blu dhe të kuqe dhe ua shpërndan nxënësve.
3. **Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë shembullin *Kalorësi i egër* nga R. Shuman me detyrë që të njohin nëse muzika është e ngadaltë apo e shpejtë. Nëse muzika është e ngadaltë, nxënësit ngrenë rrethin blu, nëse është e shpejtë, ngrenë rrethin e kuq (pritet që nxënësit të ngrenë rrethin e kuq).
4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Në dëgjimin e dytë nxënësit përshkruajnë karakterin e kompozimit - nëse është i ndjeshëm, i butë, i prerë, energjik etj. Ata argumentojnë përzgjedhjet e tyre.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë shembullin *Adaxhio* nga T. Albinoni me të njëjtën detyrë për njohjen e shpejtësisë së muzikës (pritsshmëria është ngritja e rrethit blu për muzikën e ngadaltë). Përshkruajnë shpejtësinë e kompozimit me fjalët e tyre.
6. **Hapi/aktiviteti i gjashtë:** Në dëgjimin e dytë nxënësit përshkruajnë me fjalët e tyre karaktere-

rin e kompozimit dhe verifikojnë se kompozimi është i butë, i trishtë, i ndjeshëm.

- 7. Hapi/aktiviteti i shtatë:** Nxënësit dhe nxënëset dëgjojnë të dy kompozimet dhe krahasojnë shpejtësinë e tyre.

Vërejtje: Sipas të njëjtit parim, të realizohet një orë mësimi për krahasimin e forcës-intensitetit të interpretimit.

Shembuj të propozuar: A. Haçaturjan - *Loja e shpatave*; P. I. Çajkovski - *Koncert për piano dhe orkestër në b-mol* (koha I); R. Shuman - *Ëndërrimi*; K. Orf - *Karmina Burana*, O Fortuna.

DITARI I DËGJIMEVE

Muzika dhe emocionet

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mëimit nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

- të përdorë vizatime, lëvizje ose tregime për të shprehur mendimet personale, imazhet dhe ndjenjat për shembujt muzikorë;
- të bisedojë me të tjerët për përjetimin muzikor të tij/saj dhe ta argumentojë atë.

Incizimi (shënime tingullore): A. Haçaturjan: *Loja e shpatave*

A. Vivaldi: *Dimri*

J. Shtraus: *Në Danubin e bukur blu*

F. Mendelson: *Kënga e pranverës*

Ecuria e orës

- 1. Hapi/aktiviteti i parë:** Në pjesën hyrëse të orës nxënësit dhe nxënëset kujtojnë shembujt muzikorë që kanë dëgjuar në orët e mëparshme. Ata së bashku me mësuesen/mësuesin konstatojnë se muzika është e rëndësishme dhe ka gjuhën e vet – mund të përshkruajë ndjenjat, stinët e vitit, disponimin.
- 2. Hapi/aktiviteti i dytë:** Mësuesja/mësuesi transmeton radhazi katër shembuj muzikorë. Shpjegon nxënësve/nxënësese se nuk do të flasë, por do të bëjë lëvizje dhe hapa të caktuar, dhe ata duhet të zbulojnë bazuar në to se cilat emocione përshkruan shembulli.
- 3. Hapi/aktiviteti i tretë:** Nxënësit/nxënëset dëgjojnë kompozimin e parë – A. Haçaturjan:

Loja e shpatave. Gjatë dëgjimit, deri sa zgjat shembulli, mësuesja/mësuesi tregon me pantomimë luftën, shpatat dhe kërcen. Nxënësit/nxënëset kuptojnë se bëhet fjalë për një karakter luftarak të kompozimit, ku shfaqen emocione të forta: guxim, shqetësime...

4. **Hapi/aktiviteti i katërt:** Mësuesja/mësuesi lëshon kompozimin tjetër – A. Vivaldi, *Dimri*. Me pantomimë tregon që është ftohtë, ecën me vështirësi, është e lodhur. Nxënësit dhe nxënëset duhet të njohin emocionet: frikë, trishtim, dhimbje.
5. **Hapi/aktiviteti i pestë:** Mësuesja/mësuesi lëshon kompozimin – J. Shtraus, *Në Danubin e bukur blu*. Gjatë muzikës ai/ajo kërcen dhe luan, dhe nxënësit duhet të njohin emocionet: gëzim, lumturi, lojëra.
6. **Hapi/aktiviteti i gjashtë:** Mësuesja/mësuesi lëshon kompozimin e F. Mendelsonit, *Kënga e pranverës*. Lëviz lehtë nëpër klasë, me gëzim dhe entuziazëm. Nxënësit dhe nxënëset njohin emocionet: gëzim, lumturi.
7. **Hapi/aktiviteti i shtatë:** Mësuesja/mësuesi i udhëzon nxënësit dhe nxënëset të hapin librin dhe në Ditarin e dëgjimeve, në hapësirën bosh, të “ngjyrosin emocionet” që kanë dëgjuar në shembujt muzikorë. Çdo hapësirë boshe ka një numër. Nxënësit dhe nxënëset komentojnë mes vete ngjyrat dhe shpjegojnë pse kanë zgjedhur ngjyrën për secilin shembull. Përveç ngjyrave, nxënësit dhe nxënëset mund të vizatojnë çfarë duan, gjë që i kujton shembullin muzikor të dëgjuar.

Vërejtje: Mësuesja/mësuesi nuk përmend titujt e shembujve muzikorë sepse qëllimi i dëgjimit është që nxënësit dhe nxënëset të ndjejnë emocionet e veprave muzikore dhe të përshkruajnë përjetimin e tyre.

SHTOJCË

Loja muzikore

Vërejtje: Kjo lojë nuk është planifikuar të trajtohet si temë e pavarur, por mund të integrohet në orë për trajtimin e tempit, dinamikës (ngjyrimin), si dhe në klasat më të larta për trajtimin e koncepteve-termave të tjerë muzikorë.

Rezultatet e të nxënit

Gjatë mësimin nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

– të improvizojë lëvizje duke dëgjuar shembuj muzikorë.

Incizimi (shënime tingullore): Shembuj të llojeve të ndryshme të tempit dhe dinamikës

Ecuria e orës

Materialet dhe mjetet e nevojshme për realizimin e orës: Mësuesja/mësuesi do të përgatisë materialet, do të ngjisë shiritat në dyshtet e klasës dhe do të vendosë topa ose toptha me ngjyra të ndryshme (të kuqe dhe blu) para nxënësve/nxënësve.

- 1. Hapi/aktiviteti i parë:** Mësuesja/mësuesi u shpjegon nxënësve/nxënësve se do t'i rreshtojë në një kolonë në mes të klasës dhe do t'u transmetojë-lëshojë shembuj muzikorë që ndryshojnë në shpejtësi. Nga njëra anë është hapësira për kolonën ku në fillim janë topat e kuq, kurse nga ana tjetër është hapësira për kolonën ku në fillim janë topat blu. Kur mësuesja/mësuesi lëshon një shembull të shpejtë, nxënësit duhet të hidhen në kolonën për krah, aty ku janë topat e kuq, ndërsa kur lëshon një shembull të ngadaltë, duhet të hidhen në kolonën ku janë topat blu. Nxënësi/nxënësja që gabon kolonën del nga loja, ndërsa të tjerët vazhdojnë.
- 2. Hapi/aktiviteti i dytë:** Në të njëjtën mënyrë, loja realizohet edhe për dinamikën ose për ndonjë koncept-term tjetër muzikor që duam ta përforcojmë përmes lojës.

LITERATURA

Vasileviq Zorisllava, *Muzički bukvar (Abetarja muzikore)*, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, Beograd, 1991.

Vasileviq Miodrag, *Narodne melodije Crne Gore (Meloditë popullore të Malit të Zi)*, Instituti i muzikologjisë, Beograd, 1965.

Vujiçiq Branka, Kostiq Sunçica, Gjurihiq Snezhana, Naumovski Aleksandra, *Čudesni svijet zvukova 2 (Bota e mrekullueshme e tingujve 2)*, Kultura muzikore për klasën e dytë të shkollës fillore, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2005.

Ivanoviq Nada, *Muzika u osnovnoj školi (Muzika në shkollën fillore)*, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2008.

Iliq Vlladica, *Muzička kultura za drugi razred osnovne škole (Kultura muzikore për klasën e dytë të shkollës fillore)*, Qendra Kreative, Beograd, 2016.

Jabllanov Nada, *Narodne pesme i igre za decu, roditelje, vaspitače i učitelje (Këngë dhe vallëzime/lojëra popullore për fëmijë, prindër, edukatorë dhe mësues)*, botimi i dytë, Qendra Kreative, Beograd, 2006.

Martinoviq-Bogojeviq Jellena, Papiq Millena, Durkoviq Bilana, *Čarolija muzike 2, Magjia e muzikës 2*, Kultura muzikore për klasën e dytë të shkollës fillore, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2013.

Programi i lëndës për ciklin e parë të shkollës fillore, Enti për shkollim, Podgoricë, 2009.

Programi i lëndës i KULTURËS MUZIKORE për klasat I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe IX të shkollave fillore, Enti për shkollim, Podgoricë, 2017.

Stokoviq Petar, *Nastava muzičke kulture (Mësimdhënia e kulturës muzikore)*, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, Beograd, 1988.

Tomerlin Vladimir, *Muzičke igre (Lojërat muzikore)*, manuali për mësues, Libri shkollor, Zagreb, 1968.